

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

Nr. 1849 Rep.
Nr. 1435 Kol.



KONTRATE

(Për transferimin e aksioneve të shoqërisë "GLEAND-OIL" Sh.a)

Sot në Tiranë me datë 14/03/2009 (dymijë e nëntë), përpara meje noterit të Dhomës së Noterëve Tiranë, u paraqiten personalisht palët e mëposhtme:

SHITESI: Z. Iliaz Spahiu, shtetas shqiptar, lindur në Kukës, me 05.07.1969, mbajtës i pasaportës nr. S0001489, titullar i 34 aksioneve që përfaqësojnë 34% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, madhor e me zotësi të plote për të vepruar.

Dhe

BLERESI: Z. Andi Kume, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 11.12.1983, mbajtës i pasaportës nr. Z1472536, titullar i 33 aksioneve që përfaqësojnë 33% të kapitalit themeltar të Shoqërisë, madhor e me zotësi të plote për të vepruar.

MEQENESE

- Shitësi zotëron 34 aksioneve të shoqërisë të cilat përbejnë 34% të kapitalit të Shoqërisë "GLEAND-OIL" Sh.a (Shoqëria), shoqëri aksionare e themeluar dhe që ushtron aktivitetin e saj në bazë të legjislacionit shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, mbajtëse e NUIS - K82109004K.
- Shoqëria ka një kapital të regjistruar në vlerën Lek 2.000.000 (dy milion) i ndare në 100 (njëqind) aksione me vlerë nominale 20.000 (njëzet mijë) lek secili;
- Shitësi dhe Blerësi kanë rënë dakord që Shitësi të shesë Blerësit 34 aksione që përbejnë 34% të kapitalit të Shoqërisë;
- Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi aksionet e specifikuar më sipër;
- Aksionet shiten (transferohen) me vlerën e tyre nominale siç është përcaktuar me poshtë në këtë kontratë.

Meqenëse ekzistojnë kushtet më sipër, palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

1. Objekti i Kontratës

Sipas kushteve të parashikuara në këtë Kontratë, Shitësi transferon tek Blerësi dhe ky i fundit blen nga Shitësi 34 (tridhjetë e katër) aksione që përbejnë 34% të kapitalit të Shoqërisë;

2. Çmimi i shitjes

Aksionet shiten (transferohen), kundrejt vlerës së tyre nominale prej Lek 20.000 (njëzet mijë) lek, për çmimin total prej 680.000 (gjashtëqind e tetëdhjetë mijë), i cili është paguar plotësisht nga Blerësi jashtë zyrës noteriale.

3. Transferimi i pronësisë mbi aksionet

Pronësia mbi aksionet transferohet menjëherë nga Shitësi tek Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

4. Te ndryshme

Pas transferimit të pjesëve të kapitalit tek Blerësi, behet pronar i ligjshëm i 67 aksioneve që përbejnë 67% të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë dhe ushtron të gjitha të drejtat që ligji i njëjtit zotëruarit të aksioneve të përcaktuara në objektin e kësaj kontrate si nga pikëpamja e ushtrimit të së drejtës së votës dhe të pjesëmarrjes në shpërndarjen e fitimeve. Shitësi humbet të gjithë të drejtat që buronin nga aksionet e shitura dhe deklarohen se nuk ka pretendime të asnjë lloji ndaj shoqërisë dhe/ose aksionareve të saj.

5. Baza Ligjore

Kjo kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore të cilës i behet referim në këtë kontratë.

Kjo kontratë pasi u lexua prej meje Noterit, u gjet në përputhje me vullnetin e lire e të plote të palëve dhe u nënshkrua rregullisht prej tyre në praninë time në katër kopje origjinale dhe unë Noteri e vërtetoj këtë sipas ligjit.

SHITESI

Iliaz SPAHIU

BLERESI

Andi KUME

NOTERI